

VENDIM
Nr. 30, datë 7.12.2012

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT E DHËNIES
DHE RINOVIMIT TË LICENCAVE PROFESIONALE PËR SUBJEKTET JURIDIKE E FIZIKE QË
USHTROJNË VEPRIMTARI NË SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë [6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencave dhe të procedurave të aplikimit për licencë të personave fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari në sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”](#), dhe rregullores së licencimit të ERRU-së, miratuar me vendim të KKRR-së, nr. 29, datë 8.12.2009, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në [rregulloren “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”](#), miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, bëhen këto ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

a) Te neni 11 “Rinovimi i licencës”, fjalia e parafundit:

“Kriteret për marrjen e vendimit nga KKRRU-ja janë të njëjta si në rastin e licencimit”, shfuqizohet.

b) Pas nenit 11 shtohet neni 11/1, si më poshtë:

1. Në rastet e ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe/ose drejtuesit teknik, i licencuari duhet të aplikojë për rinovimin e licencës brenda 30 ditëve nga lindja e këtyre ndryshimeve.

Kërkesa për rinovimin e licencës duhet të shoqërohet me këto dokumente:

a) Në rastet e ndryshimit të drejtuesit ligjor:

- Ekstraktin e QKR-së plotësuar me administratorin e ri;

- CV e drejtuesit të ri ligjor;

- Dëshminë e penalitetit (formular aplikimi dhe fotokopje e dokumentit të identifikimit);

- Deklaratën me shkrim të drejtuesit ligjor, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të nxjerra nga ERRU-ja, të standardeve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi;

- Autorizimin nga pronari për drejtuesin ligjor, i cili jep të drejtën për të kryer të gjitha veprimtaritë për aplikimin dhe përdorimin e licencës përkatëse;

b) në rast të ndryshimit të drejtuesit teknik:

- CV e drejtuesit të ri teknik;

- Dëshminë e penalitetit (formular aplikimi dhe fotokopje e dokumentit të identifikimit);

- Deklaratën me shkrim të drejtuesit teknik, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga ERRU-ja, të standardeve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi;

- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë.

I licencuari përjashtohet nga detyrimi i pagesës së licencimit në rastet e rinovimit të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor/teknik.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi